Македонска Банкарска Асоцијација

KUIZI EVROPIAN I PARAVE

**TESTI I DYTË PËRGADITËS**

**1. Nga buron emri denar?**

A: Nga një freskë në kishën Shën Pantelejmon në Shkup

**Б: Nga monedha romake me emër të njëjtë – denarius-i Latin**

B: Nga shteti i mëparshëm - Jugosllavia

Г: Nga një mozaik në Stobi

**2. Në vendin tonë përdoren kartëmonedhat nga MKD:**

A: **10, 50, 100, 200, 500, 1000, 2000**

Б: 10, 50, 100, 500, 1000, 2000, 5000

B: 10, 20, 50, 100, 500, 1000, 2000

Г: 10, 20, 50, 100, 200, 500, 1000, 2000

**3. Cili institucion vendos se si do të duken paratë?**

A: Ministria e financave e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Б: **Banka popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut**

Ц: Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Д: Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut

**4.Çfarë nuk është shërbimi bankar:**

A: Lëshimi i kartelave debitore dhe kreditore

Б: Kryerje e qarkullimit pagesor

B: Internet bankim dhe ai celular

**Г: Printim i kartëmonedhave dhe monedhave**

**5. PIN-kodi nga kartela pagesore duhet të:**

A: Shkruhet në anën e pasme të kartelës

Б: **Mbahet në mend dhe të mos shkruhet**

B: Shkruhet në telefon

Г: Tregohet miqve më të mirë

**6. Me kartelën debitore nuk mundet të:**

А: Kryhet pagesë përmes POS terminaleve
Б: Tërhiqen para të gatshme nga një bankomat
**В: Shpenzohet më shumë se “minusi i miratuar“**
Г: Bëhet pagesë përmes internetit

**7. Kursimi në euro është:**

А: Joekonomik
Б: Në denarë
В: Ekonomik
Г: **Devizor**

**8. Kursim i afatizuar është kur:**

А: Në paratë e investuara nuk fitojmë interes
Б: **Paratë i investojmë për një periudhë/afat të caktuar**
В: Paratë e investuara dyfishohen
Г: Për paratë e investuara paguajmë kosto

**9.Llogaria e transaksionit mundëson që:**
А: Të pranoni dhe të kryeni pagesa
Б: Të bëni transfer të mjeteve nga një në llogari tjetër të transaksionit
В**:** Të transferoni mjete në një depozitë të maturuar
**Г: Të gjitha që janë cekur**

**10. Të blehet diçka me kredi nënkupton që:**

А: Produkti është marrë në lirim
Б: Ajo çfarë është blerë është e siguruar
В: **Produkti është blerë me para të huazuara**
Г: Është blerë diçka me para personale

**10. Si shfrytëzues i kredisë, duhet që:**

**А: Të lexoni dhe t’i kuptoni të gjitha afatet dhe kushtet e kredisë**
Б: T’i fitoni paratë
В: T’i shpenzoni paratë nga kredia sa më shpejtë
Г: Të mos kujdeseni për pagesën e kredisë

**11. Kredia më e volitshme ëhtë:**

А: MKD100,00 me normë të interesit prej 3,5%

Б: MKD1.000,00 me normë të interesit prej 3%
В: **MKD10.000,00 me normë të interesit prej 2,5%**
Г: MKD10,00 me normë të interesit prej 5,5%

**12. Kur të merret një kredi, çfarë duhet paguar çdo muaj?**

А: Shlyerje mujore të principalit për t'u zvogëluar borxhi
Б: **Gjithsej shlyerja e principalit dhe interesit për t'u zvogëluar borxhi**
В: Nuk duhet paguar asgjë, ngase nuk keni para
Г: Vetëm interesi

**13. Buxheti i shtetit përbëhet prej:**

А: Të ardhura publike dhe shpenzime kapitale
**Б: Të ardhura publike dhe shpenzime publike**
Ц: Tatime dhe shpenzime publike
Д: Bitcoins

**14. Pjesëmarrës kryesorë në tregun e letrave me vlerë janë:**

А: Të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut
Б: Emetuesit dhe ndërmjetësit
Ц: Investitorët
Д: **Emetuesit, investitorët dhe ndërmjetësit**

**15. Qeveritë mund të emetojnë:**

А: **Obligacione**
Б: Letra me vlerë të konvertueshme
В: Aksione
Г: Asnjërën nga të cekurat

**16. Në tregun sekondar të letrave me vlerë bëhet:**

А: Tregtim me patundshmëri
Б: Grumbullim i mjeteve për financim
В: Shkëmbim i monedhave
**Г: Tregtim me letra me vlerë**

**17. Cilët subjektë janë pjesë e tregut për sigurime?**

А. Shoqëritë për sigurime
Б. Shoqëritë brokere për sigurime

Ц. Shoqëritë për përfaqësim në sigurime

**Д. Të gjitha të cekurat**

**18. A është personi i siguruar i obliguar që të paraqet ndodhinë e një dëmi?**

**A: Po, duhet të njoftojë shoqërinë për sigurime dhe të dorëzojë të gjitha dokumentet e duhura**

Б: Jo, nuk ka nevojë të njoftojë shoqërinë për sigurime se ka ndodhur një dëm

Ц: Të bëhet sikurse asgjë nuk ka ndodhur

Д: Të njoftojë Agjencionin për mbikëqyrje të sigurimeve

**19: Çfarë sigurimi pensional ekziston?**

**A: I obligueshëm dhe vullnetar**

Б: I obligueshëm

В: Vullnetar

Г: Dixhital

**20. Çfarë bën shoqëria private pensionale?**

**A: I investon mjetet në fondin pensional**

Б: Organizon lojëra shoqërore për pensionistët

В: I dërgon pensionistët në banjo

Г: Kryen supervizion të fondeve pensionale